

Data: 15 Shtator 2018

KONCEPT NOTA

Sfondi dhe arsyetimi

Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazimin e Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women) përmes projektit të saj rajonal **“Fuqizimi politik i grave, pjesëmarrja dhe kontributi në procesin e paqes dhe sigurisë në Ballkanin Perëndimor”** mbështet rrjetet ekzistuese dhe të ardhshme të Ballkanit Perëndimor me qëllim të fuqizimit të bashkëpunimit, koordinimit dhe kapaciteteve për të punuar së bashku në çështjet nën-rajonale të dedikuara për përmirësimin e agjendës së grave, paqes dhe sigurisë. Këto rrjete përfshijnë edhe **Lobin Rajonal të Grave për Paqe, Siguri dhe Drejtësi në Evropën Juglindore (LRGEJL)**, i dedikuar për ndërtimin e paqes dhe reformave demokratike, zbatimin e agjendës për gratë, paqen dhe sigurinë si dhe drejtësinë tranzicionale.

UN Women ka mbështetur krijimin dhe zhvillimin e LRGEJL që nga themelimi i tij në vitin 2006 si avokues dhe lobi për gratë, paqen dhe sigurinë në Evropën Juglindore në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal. Kjo është një organizatë rajonale e grave për ndërtim të paqes dhe si e tillë është unike në rajon dhe më gjerë. Anëtarët e LRGEJL janë gratë e spikatura (prominente) dhe me ndikim në politikë, si dhe aktivistet për të drejtat e grave nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia.

Me zotimin e fuqizimit të grave dhe arritjes së barazisë gjinore duke përfshirë perspektivën gjinore në të gjitha politikat dhe aktivitetet në rajon, qëllimi i LRGEJL është të fuqizoj pozitën e grave në proceset e vendimmarrjeve, paqes dhe sigurisë në vendet e pas-konfliktit, duke avancuar në mënyrë paralele proceset e ndërtimit të paqes, demokratizimit, drejtësisë dhe pajtimit në rajon, duke kontribuar kështu në zbatimin e RKSMB 1325. LRGEJL i dedikohet sigurimit të paqes së qëndrueshme dhe sigurisë përmes reformave të thella me qëllim që të përshpejtohet integrimi Evropian dhe Euro-Atlantik i rajonit.

Rrjeti LRGEJL përfshin gratë nga nivelet e larta politike dhe shoqërisë civile, ministret, deputetet, zyrtaret e larta të qeverisë dhe aktivistet e shoqërisë civile nga i gjithë Ballkani Perëndimor. Të zotuar ndaj qëllimit të paqes dhe stabilitetit, sigurisë gjithëpërfshirëse njerëzore, thyerjes së barrierave të politikave etno-centrike dhe promovimit të drejtave të grave dhe barazisë gjinore, me theks të veçantë në pjesëmarrjen e grave në proceset vendimmarrëse, LRGEJL ka dëshmuar të jetë një zë i rëndësishëm i grave në proceset politike, ndërtimit të paqes dhe pajtimit në tërë rajonin.

LRG EJM ka një Bord Këshillues¹, që përbëhet nga figura të spikatura ndërkombëtare, avokues të paqes dhe politikane të cilët kontribuojnë me njohuri dhe ekspertizë për të fuqizuar punën e LRGEJL dhe mbështesin misionin dhe strategjitë e saj.

¹Anëtarët e Bordit Këshillues: **Dr. Ursula Plassnik**, Ambasadore në Francë/ Ish-ministre e Jashtme Austriake; **Elisabeth Rehn**, ish-ministre e Mbrojtjes në Finlandë dhe e dërguara e OKB për të Drejtat e Njeriut në Ballkan; **Osnat Lubrani** Koordinatore e Përhershme e OKB-së, Përfaqësuese Rezidente e UNDP-së, Zyra Shumëkombëshe, Fixhi; **Franziska Brantner**, Anëtare e Parlamentit Evropian; **Mirjana Feric-Vac**, Nënkyetare e "Socialist International (SI)" dhe nënkryetare e grave të SI në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore; **Ana Maria Gomes**, Anëtare e Parlamentit Evropian dhe Zëvendës Kryetare e Nënkomitetit



LOBI RAJONAL I GRAVE për PAQE, SIGURI dhe DREJTWSI në EJL (<http://LRGEJL.org/>)

Ky Bord Këshillues mund të mobilizohet në mbështetjen e çështjeve që përputhen me sferat në të cilat ai mund të ndikojnë si dhe në fushat e tij të ekspertizës.

E njohur nga institucionet ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare si një organizatë e fortë për ndërtimin e paqes, drejtat e grave dhe sigurinë, LRGEJL shërben si model për promovimin e bashkëpunimit rajonal përkundër dallimeve përgjatë vijave politike dhe etnike drejt ndërtimit të një të ardhmeje më të mirë, madje edhe pas luftërave dhe konflikteve. LRG EJL fokusohet në mbështetjen e proceseve të paqes, veçanërisht në zbatimin e marrëveshjeve të paqes në rajonin e Ballkanit Perëndimor siç janë Marrëveshjet e Brukselit dhe Marrëveshja e Ohrit si dhe marrëveshjet e mëparshme siç është Marrëveshja e Dejtonit, Marrëveshja e Rambujesë dhe Marrëveshja e Erdut, si dhe në ndërtimin e urave dhe dialogut mes politikanëve të grupeve të ndryshme, gjë që mbetet një gjë e rrallë në rajonin e Evropës Juglindore

Si pjesë e qëllimeve të tije për ndërtimin e paqes dhe fushatës së avokimit për të avancuar paqen dhe stabilitetin në rajonin e Ballkanit Perëndimor, LRGEJL në bashkëpunim të ngushtë me UN Women ka organizuar një tryezë rrumbullakët me temën "Gratë, Bashkëpunimi Rajonal dhe Integrimi Evropian" më 14 qershor të vitit 2018, në Budva të Malit të Zi. Pjesëmarrëset u takuan me qëllimin që të identifikojnë mënyrat që gratë të luajnë një rol më të madh në ndërtimin e paqes, sidomos në lidhje me zbatimin e Dialogut të Brukselit mbi normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe Integrimin Evropian të Ballkanit Perëndimor.

Kjo tryezë e rrumbullakët u organizua si veprim pasues i një numri të dialogjeve ndëretnike që u mbajtën më parë dhe u përqendrua në nxitjen e dialogut konstruktiv rajonal mes politikanëve femra në Ballkanin Perëndimor.

Si e tillë, Tryeza Rajonale e Dialogut shërbeu si forum për të vendosur një dialog të drejtpërdrejtë, dhe për të forcuar bashkëpunimin dhe komunikimin mes udhëheqësve politike të grave nga parti të ndryshme politike në të gjithë rajonin. Qëllimi kryesor i konferencës ishte identifikimi i mënyrave për krijimin e paqes së qëndrueshme dhe integrimin evropian në të gjithë Ballkanin Perëndimor, ku gratë luajnë një rol të rëndësishëm dhe qendror vendimmarrës në këtë proces të rëndësishëm paqësor dhe politik. Më tej, kjo vuri në pah rëndësinë e marrëdhënieve paqësore, fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimit rajonal si kriter kyç për Integrimin Evropian. Siç u përmend më lart, theks i veçantë është vënë në dialogun e lehtësuar nga BE-ja për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (Dialogut të Brukselit) si kontributi kyç për paqen dhe stabilitetin në rajon dhe si një mënyrë për përshejtimin e integritit evropian. Gjatë kësaj konference u adresuan fuqizimi i gruas në qeverisje demokratike dhe ndërtimi i paqes në gjithë rajonin si dhe ndërtimi i paqes në nivel lokal, ku që të dyja janë të rëndësishme për paqen dhe sigurinë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

Për shkak të frymës konstruktive dhe të orientuar drejt dialogut, tryeza e rrumbullakët rajonale në Budva jo vetëm që tregoi rëndësinë, vlerën dhe nevojën e një forumi të tillë, por gjithashtu hapi rrugën për dialogun e mëtejshëm dhe më intensiv midis grave. Me qëllimin që të përmirësohet mirëkuptimi i ndërsjellë dhe të identifikohen mënyrat në të cilat gratë mund të fuqizojnë gratë e tjera në vendimmarrje dhe ndërtimin dhe avancimin e paqes dhe stabilitetit të qëndrueshëm, bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë në Ballkanin Perëndimor, 15 shtator të vitit 2018, është planifikuar një tryezë e rrumbullakët rajonale, e organizuar nga UN Women dhe

për Siguri dhe Mbrojtje; **Luisa Morgantini**, Ish-nënkryetare e Parlamentit Evropian; **Doris Pack**, Anëtare Parlamentit Evropian; ish-kryesuese e Delegacionit për Marrëdhëniet me Evropën Juglindore; Flora Macula, Udhëheqëse e UN Women Kosovë.

LOBI RAJONAL I GRAVE për PAQE, SIGURI dhe DREJTWSI në EJM (<http://LRGEJL.org/>)

LRGEJL. Pjesëmarrësit do të përfshijnë anëtarët e Komitetit Drejtues të LRGEJL, gratë politike nga rajoni, deputetet nga Kosova dhe Serbia, nga partitë e ndryshme politike, përfshirë edhe ato udhëheqëse, si rrugë përpara drejt vendimmarrjes si dhe zyrtarë të tjerë dhe përfaqësues të shoqërisë civile nga rajoni i LRGEJL përfshirë Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kroacinë, Kosovën, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë.

Kjo tryezë e rrumbullakët është pjesë e një strategjie që parasheh një konferencë më të madhe rajonale për dialog, ku përfshihen gratë politike nga Kosova dhe Serbia, që planifikohet të mbahet në mes të nëntorit të vitit 2018 dhe aktivitetet përcjellëse në gjysmën e parë të vitit 2019.

Duke zbatuar aktivitetet e parashikuara, projekti do të kontribuoj në fuqizimin politik të grave, dhe në procese më të fuqishme dhe gjithëpërfshirëse të ndërtimit të paqes në të gjithë Ballkanin Perëndimor.

Një sfidë e vërtet është situata vazhdimisht e ndjeshme politike mes Kosovës dhe Serbisë. Projekti synon të kontribuoj në nxitjen e dialogut dhe mirëkuptimit më të madh reciprok, duke ofruar në të njëjtën kohë mbështetje për gjetjen e një marrëveshje ligjërisht detyruese mes palëve.

Përfundimisht, synimi i kësaj serie të tryezave të rrumbullakëta është të nxitet edhe më tutje normalizimi dhe marrëdhëniet paqësore mes Kosovës dhe Serbisë në kuadër të kornizës së dialogut të Brukselit. Përveç kësaj, këto platforma shërbejnë edhe si inspirim për gratë në kontekstet e tjera që të angazhohen dhe përfshihen në procesin e ndërtimit të paqes lokale. Përvoja e jashtëzakonshme e grave politike dhe përfaqësuese të shoqërisë civile nga rajoni do të mundësoj ndarjen dhe shkëmbimin e përvojave përkatëse, praktikave të mira dhe modeleve më të mira të ndërtimit të paqes që zbatohen në rajon si dhe mësimet e nxjerra nga e kaluara. Roli vendimtar i grave të angazhuara në proceset e ndërtimit të paqes lokale do të adresohet dhe fuqizohet më tutje, duke mbajtur në mend që proceset e qëndrueshme të ndërtimit të paqes kërkojnë angazhimin e grave në të gjitha nivelet. Fokusi në këtë drejtim do vendoset mbi mënyrën e rritjes së pjesëmarrjes së grave në fazën e ardhshme finale të dialogut të Brukselit, i cili gjatë shtatë viteve të kaluara ka dështuar në masë të madhe sa i përket përfshirjes së grave, me përjashtim të krye-negociatoreve nga ana e Kosovës gjatë këtyre shtatë viteve e cila është grua.

Në përputhje me ngjarjet e mëparshme, si dhe duke përdorur platformën dhe përfaqësimin e saj rajonal, iniciativa e LRGEJL paraqet një forum të çmuar për gratë politike/deputetet e Kosovës dhe Serbisë që të eksplorojnë mënyrat për tejkalimin e mosmarrëveshjeve që kanë vazhduar për një kohë të gjatë, si dhe në të njëjtën kohë të përmirësohet efikasiteti dhe ndikimi i tyre në vendimmarrje. Ky veprim bie brenda fushëveprimit të misionit të LRGEJL për lehtësimin dhe promovimin e paqes, stabilitetit, marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor si standarde kyçe evropiane për integrim evropian dhe që përputhen me strategjinë e sapo lansuar të BE-së për Zgjerim. Qëndrimi i LRGEJL është që gratë duhet të kenë një rolë qendror dhe kuptimplotë si dhe të përfaqësohen në mënyrë të barabartë në këto procese të rëndësishme duke siguruar një të ardhme evropiane dhe euro-atlantike për të gjithë rajonin.

LRGEJL ka pasur arritje solide në përpjekjet e tilla të paqes, pasi tashmë ka organizuar disa dialogje ndëretnike me gratë nga e gjithë rajoni si dhe ka punuar për të përmirësuar lokalizimin e përpjekjeve për ndërtimin e paqes. Veprimet e shumfishta që dalin nga dialogu strategjik mes përfaqësueseve të grave nga komunat me shumicë serbe në Kosovë dhe Znj. Edita Tahiri, Ish-Ministre për Dialog në Kosovë dhe kryenegociatore në dialogun me Serbinë të lehtësuar nga BE-ja dhe të mbështetur nga SHBA-të, tashmë janë zbatuar me sukses në nivel komunal.

LOBI RAJONAL I GRAVE për PAQE, SIGURI dhe DREJTWSI në EJL (<http://LRGEJL.org/>)

LRGEJL ka realizuar dialogje të ngjashme ndër-etnike në Maqedoni për të mbështetur gratë që të luajnë rolin e tyre në tejkalimin e krizës së fundit politike në Maqedoni si dhe për promovuar të drejtat e njeriut dhe harmonin.

Më specifikisht, përgjatë viteve dhe me mbështetje të vazhdueshme nga UNWOMEN, si dhe me financimin bujar nga Suedia, Norvegjia dhe Finlanda, LRGEJL ka organizuar disa konferenca rajonale si më poshtë:

- Gratë në Situatat pas Konfliktit (2008) në Prishtinë, Kosovë;
- Gratë dhe ndërtimi i paqes në BP (2010) në Shkup, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë;
- Qasja e grave në drejtësi në vendet e pas konfliktit (2012) në Zagreb, Kroaci;
- Drejt rrugës për fuqizimin e Gruas në Politikë, Procesin e paqes dhe integrimin në Bashkimin Evropian (2014) në Sarandë, Shqipëri;
- "Dialogu rajonal mes grave deputete nga Serbia dhe Kosova - Gratë dhe përfaqësuesit e komuniteteve nga katër komunat veriore në Kosovë (2015) Mitrovicë, Kosovë;
- "Rëndësia dhe Roli i Grave në Maqedoni dhe Procesin e Integrit Evropian (2015) Shkup, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë; "Fuqizimi i Grave për Stabilitetin Rajonal" (2015) Prishtinë, Kosovë;
- "Gratë e Kosovës punojnë së bashku për integrimet evropiane" (2016), Prishtina, Kosovë;
- "Gratë në vendimmarrje në nivel lokal/Roli i grave kryetare të komunave si agjente të mundshme të ndryshimit "(2016) Tetovë, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.
- "Fuqizimi i Grave për Stabilitetin Rajonal "(2015) Prishtinë, Kosovë;
- "Gratë e Kosovës punojnë së bashku për integrimet evropiane" (2016), Prishtina, Kosova;
- "Gratë në vendimmarrje në nivel lokal/Roli i grave kryetare të komunave si agjente të mundshme të ndryshimit "(2016) Tetovë, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë;
- Tryeza e rrumbullakët mbi përpjekjet për ndërtimin e paqes në nivel komunal (2017) Prishtinë, Kosovë;
- "Gratë së bashku në mbështetje të grave, paqes dhe integritit në BE"- Avancimi i pozitës së gruas dhe bashkëpunimit shumë-etnik në nivel lokal (2018) Prishtinë, Kosovë;
- Gratë, bashkëpunimi rajonal dhe integrimi evropian - Nxitja e dialogut rajonal midis politikanëve femra në Ballkanin Perëndimor (2018), Budva, Mali i Zi.

Të gjitha konferencat e sipërpërmendura u përcollën me një marrëveshje mes të gjithë pjesëmarrësve për një deklaratë të konferencës, duke theksuar pikat kryesore të vendimit, por gjithashtu edhe për zotimin që të vazhdohet dhe intensifikohet rrjetëzimi dhe forcimi i bashkëpunimit mes gjithë akterëve relevantë, që është vendimtar për stabilizimin e rajonit dhe forcimin e perspektivës së tij evropiane. Në veçanti, përmes dialogut ndër-etnik në nivel komunal janë bërë përmirësime të konsiderueshme sa i përket bashkëpunimit ndër-etnik mes grave nga komunitetet e ndryshme në Kosovë. Pjesëmarrësit u zotuan që të mbështesin akterët relevant në adresimin e çështjeve si luftimi dhe parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe promovimi i ndërtimit të paqes në nivel komunal, por edhe zhvillimi i rekomandimeve konkrete në lidhje me përmirësimin e qasjes, pjesëmarrjes dhe rolit të gruas në procesin e paqes dhe sigurisë në rajon.

Për të vazhduar dhe përmirësuar dialogun për ndërtimin e paqes dhe besimit, gjatë takimit të radhës në Budva, pjesëmarrësit shprehën rëndësinë dhe u dakorduan për nevojën e takimeve përcjellëse për arritjen e synimeve të cekura më lartë. Pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e zgjerimit të pjesëmarrjes në takime të tilla të dialogut me artistë, aktivistë për paqe dhe minoritetet etnike. Nxitja e dialogjeve të hapura dhe të sinqerta politike midis palëve kryesore të interesuara është çelësi për arritjen dhe avancimin e paqes dhe stabilitetit të qëndrueshëm në rajon

dhe forcimin e institucioneve demokratike të Kosovës dhe Serbisë në procesin e integritetit të tyre evropian.

Rezultatet e pritura:

- Gratë nga të gjitha komunitetet në Kosovë do zhvillojnë aftësitë e tyre për negociim /ndërmjetësimi dhe aktivitetet e përbashkëta me komunitetin në ndërtimin e besimit dhe paqes.
- Ndërtimi i besimit, dialogu ndëretnik dhe ndërveprimi mes grave politike nga Kosova dhe Serbia që do të jenë të dobishme për të gjitha komunitetet në Kosovë dhe Serbi
- Do të zhvillohet Deklarata e Përbashkët mbi gjetjet dhe rekomandimet kryesore nga Konferenca rajonale e dialogut dhe do të ndahet me Qeveritë e Serbisë, Kosovës dhe rajonit, BE-së, OKB-së dhe organizatave të tjera relevante ndërkombëtare përmes rrjeteve të LRGEJM.
- Vazhdimi i krijimit të lidhjeve mes grave në politikë nga Kosova dhe Serbia drejt ndërtimit të vazhdueshëm të paqes dhe prosperitetit
- Do demonstrohet zotimi për rritjen, intensifikimin dhe fuqizimin e rrjetëzimit rajonal dhe bashkëpunimit mes grave udhëheqëse politike nga Kosova, Serbia si dhe gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor
- Diskutimi dhe përmirësimi i perspektivave të reja mbi mënyrën e fuqizimit të mëtejshëm të grave në vendimmarrje, qeverisje demokratike dhe ndërtim të paqes.
- Rezultatet nga konferencat e nivelit të lartë do të transmetohen gjerësisht dhe do të diskutohen gjatë Ditës së Hapur Globale të Kombeve të Bashkuara për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, e bashkë-organizuar nga UN Women dhe Misioni i OKB-së në Kosovë.